



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO



MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 21 dhe 42 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik

Titulli i kontratës:

“Servisimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës”-Ritender

Numri i aktivitetit të prokurimit:

Nr i prokurimit	626-24-4320-2-2-1
Nr i brendshëm	626-24-006-2-2-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Çmimi total për njësi i të gjithë artikujve €	Vlera totale e ofertës në bazë të poentimit €
1.	<i>Zeqir Krasniqi B.I, Rr. HAJDIN BERISHA, Pn, 23000 Suharekë</i>	67,420.00 €	12,617.20 €
2.	<i>Grupi i O.E GENTIAN SAKAJ B.I&ASLLAN ELEZI B.I” Rr. SKENDERBEU, Pn.,23000, Suharekë.</i>	64,967.50 €	11,933.33 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Mamushës - Zyra e Prokurimit, shpërblen me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët në bazë të poentimit: Gentian Sakaj B.I.; Asllan Elezi B.I. Rruga "Skenderbeu" p.n., Suharekë në vlerë totale të çmimit të poentuar prej: 11,933.33 €

Data: 20.06.2024

Emri dhe mbiemri i ZPP: **Gazmend Gashi**

Nënshkrimi: _____

Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.

¹Ketij formulari i bashkangjiten dhe letrat standardet e njoftimeve: B42, B45 dhe B46. (shton letrat njoftuese sipas nevojës).
B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm²

Mamushë më: 20.06.2024

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik Gentian Sakaj B.I.; Asllan Elezi B.I. Rruga "Skenderbeu" p.n.,
Suharekë

Nr i prokurimit	626-24-4320-2-2-1
Nr i brendshëm	626-24-006-2-2-1

Titulli:

“Servisimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës”-Ritender

I nderuar z. **Gentian Sakaj**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”. Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**, si përgjigje ndaj **kërkesës për tenderin në lidhje me** aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Bashkëngjitur me këtë letër është vendimi për dhënie të kontratës


Me respekt,

Gazmend Gashi

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit


Nënshkrimi

² Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar³

Mamushë më: 20.06.2024

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: *Operatorin Ekonomik: “Zeqir Krasniqi B.I, Rr. HAJDIN BERISHA, Pn, 23000 Suharekë*

Nr i prokurimit	626-24-4320-2-2-1
Nr i brendshëm	626-24-006-2-2-1

Titulli:

“Servisimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës”-Ritender

I nderuar Z. ZEQIR KRASNIQI

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;
- Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

- Nuk i keni përbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];
- Nuk i keni përbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- Nuk i keni përbushur kërkesat formale/administrative
- (Afatin e liferimit) i cili nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë për kryerjen e shërbimit.**

³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtuajtshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

- Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale
- Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale
- Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A

Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.
[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

1. Në dosje të tenderit ne nenin 5.3 dhe në njoftimin për kontratë në nenin III.1.3 është kërkuar që:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë, nënshkruajnë, vulosin dhe me tenderin e tyre të dorëzojnë afatin për kryerjen e shërbimit.

-Afati për kryerjen e shërbimit (kontrollimit, servisimit riparimit dhe dorëzimit të AK-s) nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (pesë) ditë nga data e dorëzimit të automjetit në servis.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Pra ju si O.E nuk keni paraqitur ne tenderin tuaj “Afati për kryerjen e shërbimit (kontrollimit, servisimit riparimit dhe dorëzimit të AK-s) i cili nuk është dashur të jetë më i gjatë se 5 (pesë) ditë nga data e dorëzimit të automjetit në servis”.

2. Gjithashtu në dosje të tenderit tek aneksi I është paraparë që: Pjesët janë specifikuar për secilin lloj veture veç e veç nga nr. 1-22 dhe OE janë të obliguar që të plotësojnë TE GJITHA rubrikat e çmimeve për secilën veturë sipas kategorive të poshtëshënuara përveç atyre të shënuara me (N/A) (Nuk aplikohet).

Komisioni vlerësues duke vlerësuar tenderin tuaj, kanë konstatuar se ju si O.E në dy pozicione keni ofruar çmim 0,00 €, konkretisht në pozicionet 139 - 6 (mbushja e klimës), dhe pozicioni 190 – 22 (furnizimi me pompë të benzinës), ku bazuar në Rregullore nr. 001/2022 për Prokurim Publik në nenin 40 pika 16 thotë qartazi “ në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet që të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro”.

Prandaj me datën 31.05.2024 kemi kërkuar sqarim nga ana juaj se pse nuk i keni vendosur çmimet për artikujt e lartcekur dhe ju për artikullin e parë keni deklaruar se nuk keni pasur kohë për të kërkuar sqarim në lidhje me këtë pozicion ndërsa për artikullin e dytë keni deklaruar se automjeti është nën

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

garancion dhe nuk ka nevojë për pompën e benzinës. Mirëpo edhe pse ky automjet është nën garancion ju i keni vendosur të gjitha çmimet për këtë automjet përpos pozicionit 190 – 22

Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurim Publik në nenin 40 pika 16 thotë qartazi a. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet.

Lëshimet e cekura më lart kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)